

## NJËSIA 8 Rregullat dhe ligji

### Çfarë lloj rregullash i nevojiten shoqërisë?



#### 8.1 Ligji i mirë – ligji i keq

Çka e bën ligjin të mirë?

#### 8.2 Në cilën moshë?

Si duhet të zbatohet ligji ndaj të rinjve?

#### 8.3 Ju e hartoni ligjin

Si i trajtoni kundërvajtësit e rinj?

#### 8.4 Rregullat e dëshmisë

Cilat dëshmi duhet të merren parasysh në gjykatë?

## **NJËSIA 8: Rregullat dhe ligji Çfarë lloj rregullash i nevojiten shoqërisë?**

Disa lloje të ligjeve janë themelore për udhëheqjen e drejtë dhe efikase të çdo shoqërie. Ligjet zbatohen në të gjitha situatat, për të gjithë brenda komunitetit të një vendi – edhe pse ka grupe të caktuara, siç janë fëmijët, të cilët nuk ndikohen nga disa ligje derisa arrijnë një moshë të caktuar.

Njëra prej mënyrave si ndahet e drejta është ajo që njihet si e drejta civile dhe e drejta penale. E drejta civile parasheh mënyra për zgjidhjen e kontesteve në mes të individëve dhe grupeve të njerëzve. E drejta penale mbulon sjelljen për të cilën shteti ka vendosur se duhet të kundërshtohet ose parandalohet.

Mirëpo, ligjet asnjëherë nuk mund të jenë të përkryer. Ata janë krijuar nga njeriu dhe ndonjëherë ka nevojë të ndryshohen. Ata mund të vjetrohen, të jenë joefikas ose thjeshtë të jenë të padrejtë ndaj grupeve të caktuara në shoqëri.

Ligjet asnjëherë nuk mund të ndahen nga politika. Pra, sistemet politike janë ata që i përpilojnë ligjet dhe i ndryshojnë ato. Në një sistem demokratik politik, është me rëndësi që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të barabarta të shprehin mendimin e tyre për këtë. Gjithashtu është me rëndësi që ligji të zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë qytetarëve, dhe se askush të mos jetë mbi ligjin. Ky koncept ndonjëherë njihet si sundim i së drejtës.

Më në fund, ligjet duhet të jenë në përputhshmëri me të drejtat e njeriut. Kjo është me rëndësi për të siguruar se ligjet janë të drejta dhe se ato nuk keqpërdoren si mjet për tirani apo diktaturë. Prandaj, shumica e sistemeve demokratike mbështeten në kushtetutat e shkruara, të cilat sigurojnë një kornizë të të drejtave të njeriut, e cila është mbi ligjet e vendit. Disa shtete kanë themeluar edhe gjykata kushtetuese, për të vendosur nëse ligjet janë në pajtim me kushtetutën apo jo.

### **Të mësuarit mbi Edukimin për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut**

Përmes kësaj serie të mësimeve nxënësit do të:

- avancojnë njohuritë e tyre për konceptin e ligjit dhe rëndësinë e tij në një shoqëri demokratike;
- kuptojnë se qëllimi kryesor i ligjit është që të ndihmojë njerëzit dhe të mbrojë shoqërinë;
- paraqesin një respekt më të madh për qëllimin e sundimit të së drejtës;
- mësojnë më shumë për sistemin ligjor në vendin e tyre.

## NJËSIA 8: Rregullat dhe ligji

### Çfarë lloj rregullash i nevojiten shoqërisë?

Titulli i mësimit	Objektivat	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metoda
Mësimi 1: Ligji i mirë – ligji i keq	Të informohen dhe të kuptojnë faktorët të cilët përcaktojnë se çka e bën ligjin të mirë.	Të diskutohet për rregullat e shkollës dhe të identifikohet se çka e bën një rregull shkolle të mirë. Të diskutohet për ligjet dhe të identifikohet se çka e bën një ligj të jetë i mirë. Të shqyrtohet në mënyrë kritike një fushë e ligjeve në vendin e tyre, p.sh. ligjet mbi alkoolin. Të propozojnë dhe të arsyetojnë rregullën ose ligjin e tyre të ri në shkollë.	Dy skeda për çdo nxënës – njëra e shënuar me shkronjën “A” (me të gjelbër), tjetra me shkronjën “B” (me të kuqe). Prospektet për nxënës – Ligjet mbi alkoolin në vendin tonë. Markera(shënues) dhe një fletë e madhe e letrës për çdo grup prej 4-6 nxënës. Tabelë shfletuese ose një fletë e madhe e letrës për ta ekspozuar në klasë.	Punë në grupe të vogla dhe diskutim në klasë.
Mësimi 2: Në cilën moshë?	Të shqyrtohet si zbatohet ligji ndaj të rinjve.	Të zgjidhet çështja e moshës ligjore kur të rinjtë fitojnë të drejtën të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të të rriturve. Të shqyrtojnë sa është adekuat ligji aktual për të rinjtë.	Tri fletë të mëdha të letrës të shënuara me “A”, “B” dhe “C” të vendosura në tri muret e ndryshme të klasës. Kopje të prospekteve për nxënës 8.1 – një për çdo të dytin nxënës. Markera dhe një fletë e madhe e letrës për çdo grup me nga 4-6 nxënës.	Punë në çifte, punë në grupe të vogla dhe diskutim në klasë.
Mësimi 3: Ju e hartoni ligjin	Të shqyrtohet çështja nëse të rinjtë të cilët e kanë shkelur ligjin duhet të dënohen apo jo, dhe nëse po, si	Të shqyrtohen faktorët e ndryshëm të cilët merren parasysh kur vendoset se çka është dënim i drejtë për një krim.	Një kopje e tregimit dhe informacione shtesë për mësimdhënësin.	Punë në grupe të vogla dhe diskutim në klasë.
Mësimi 4: Rregullat e dëshmisë	Të kuptohen rregullat për paraqitjen e dëshmisë në gjykatë.	Të shqyrtohen llojet e dëshmive të cilat merren parasysh në gjykatë, dhe llojin e dëshmive që do të ishte gabim të shfrytëzohen në gjykatës.	Skedat për diskutim (prospektet për nxënës 8.2) për çdo grup me nga 4-6 nxënës	Punë në grupe të vogla dhe diskutim në klasë.

## Mësimi 1

### Ligji i mirë – ligji i keq

#### Çka e bën ligjin të mirë?

<b>Objektivi i mësimnxënies</b>	Të informohen dhe të kuptojnë faktorët të cilët përcaktojnë se çka e bën ligjin të mirë.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Të diskutojnë për rregullat e shkollës dhe të identifikojnë se çka e bën një rregull shkolle të mirë. Të diskutojnë për ligjet dhe të identifikojnë se çka e bën një ligj të jetë i mirë. Të shqyrtojnë në mënyrë kritike një fushë të ligjeve në vendin e tyre, p.sh. ligjet mbi alkoolin. Të propozojnë dhe të arsyetojnë rregullën ose ligjin e tyre të ri në shkollë.
<b>Burimet</b>	Dy skeda për çdo nxënës – njëra e shënuar me shkronjën “A” (me të gjelbër), tjetra me shkronjën “B” (me të kuqe). Materialet e nxënësve – Ligjet mbi alkoolin në vendin tonë. Markera (shënues) dhe një fletë e madhe e letrës për çdo grup prej 4-6 nxënës. Tabelë shfletuese ose një fletë e madhe e letrës për ta ekspozuar në klasë.
<b>Metoda</b>	Diskutim me tërë klasën dhe punë në grupe të vogla.

### Kuti informacioni

Metoda e përdorur në këtë mësim njihet si “të mësuarit induktiv”. Përmes kësaj metode mësimdhënësi u ndihmon nxënësve të kuptojnë parimet abstrakte duke i bazuar ato në shembuj konkret. Mësimi fillon me shembuj të tillë – në këtë rast me shembuj të rregullave apo ligjeve – dhe nxënësit inkurajohen që nga këto të nxjerrin parimet e përgjithshme. Në këtë rast, parimet janë kriteret të cilat mund të zbatohen për rregullat dhe ligjet për të gjykuar nëse ata janë ligje të mira apo jo: A janë ata të drejtë? A janë të dobishëm? A janë ato në dobi të të gjithëve? A mund t’i zbatojë ato ligje policia? A janë të lehtë për t’i kuptuar dhe për t’i zbatuar?

Kur nevojiten materiale specifike, për shembull, ligjet mbi alkoolin të cilat zbatohen në atë vend, mësimdhënësi apo nxënësit e kanë për detyrë që këto materiale t’i përfshijnë në mësim.

## Mësimi

Mësimdhënësi e fillon mësimin duke i dhënë çdo nxënësi dy skeda – njëra e shënuar me shkronjën e madhe “A” (me të gjelbër) dhe tjetra me shkronjën e madhe “B” (me të kuqe).

Mësimdhënësi u tregon nxënësve se ata do të dëgjojnë disa rregulla shkollore imagjinare, dhe ata duhet të vendosin nëse mendojnë se këto do të ishin rregulla të mira apo të këqija. Për rregullat e mira ata duhet të ngrenë skedën “A”, dhe për rregullat e këqija skedën “B”.

Mësimdhënësi lexon me zë rregullat shkollore imagjinare një nga një. Çdo herë, nxënësit duhet të ngrenë njëren prej skedave të tyre – varësisht se çka mendojnë për rregullën. Rregullat e shfrytëzuara do të mund të përfshinin:

- ndalohen detyrat e shtëpisë;
- nuk lejohet ngacmimi;
- nxënësit duhet të paguajnë për të vijuar shkollën;
- nuk lejohet prurja e çamçakëzit në shkollë;
- nxënësit duhet t’i duan të gjithë mësimdhënësit e tyre;
- nxënësit duhet të kenë mundësi të zgjedhin në cilat klasë duan të shkojnë;
- mësimdhënësit e moshuar duhet të kenë një orar më të lehtë;
- telefonat celular nuk lejohen në shkollë.

Për secilën, mësimdhënësi duhet të kërkojë nga dy apo tre nxënës të ndryshëm të arsyetojnë vendimet e tyre:

- Pse mendoni se është rregull e mirë/e keqe?

Mendimet e nxënësve nuk duhet të diskutohen më tutje apo të komentohen në këtë fazë. Në vazhdim mësimdhënësi duhet ta ndajë klasën në grupe me nga 4-6 nxënës dhe të kërkojë nga nxënësit që të mundohen të gjejnë me saktësi faktorët të cilët një rregull shkollore e bëjnë të mirë:

- Çka e bën një rregull shkolle të mirë?

Grupet duhet t’i paraqesin mendimet e tyre para klasës si tërësi.

Në vijim, mësimdhënësi e përsërit tërë ushtrimin me klasën – duke lexuar me zë formulimet, nxënësit duke i ngritur skedat dhe duke arsyetuar vendimet e tyre, etj. – por këtë herë përqendrohen në ligje imagjinare, dhe jo në rregulla të shkollës. Ligjet e shfrytëzuara do të mund të përfshinin:

- të gjithë qytetarët duhet t’i përkasin religjionit të njëjtë;
- vrasja është e keqe;
- nuk lejohen gënjeshttrat;
- duhet ndaluar ushqimin e gatshëm pa vlerë;
- qytetarët duhet lejuar që vetë të vendosin se në cilën anë të rrugës duan të vozisin;
- gratë duhet paguar njëlloj sikurse burrat.

Pastaj mësimdhënësi duhet të kërkojë që nxënësit të kthehen në grupet e tyre dhe të mundohen të tregojnë faktorët të cilët e bëjnë ligjin të jetë i mirë:

- Çka e bën ligjin të mirë?

Grupet duhet t’i paraqesin mendimet e tyre para klasës si tërësi. Duke e bërë këtë, mësimdhënësi duhet të bëjë përpjekje që të orientojë të menduarit e nxënësve kah një sërë kriteresh kyçe, të cilat mund të zbatohen për ligjet dhe të cilat ndihmojnë që ato ligje t’i bëjnë të mira. Ata përfshijnë:

- paanësinë – drejtësinë dhe barazinë, siç është pagesë e barabartë për burrat dhe gratë;
- dobinë – duke mundësuar drejtimin e shoqërisë pa tronditje, siç janë ligjet mbi vozitjen për të bërë rrugët më të sigurta;

- të mirën e përbashkët – duke mos mbështetur vetëm interesat e grupeve të caktuara, siç janë të pasurit;
- ekzekutueshmërinë – shumica janë të gatshëm t’u binden ligjeve, policia është e aftë t’i zë ata të cilët i shkelin ligjet;
- thjeshtësinë – lehtë për t’i kuptuar dhe për t’i zbatuar, jo shumë të komplikuar.

Kur klasa të jetë pajtuar për këto kritere, ata duhet të ekspozohen në klasë në tabelën shfletuese për t’i parë të gjithë. Titulli për këtë ekspozim duhet të jetë “Çka e bën ligjin të jetë i mirë?”

Mësimdhënësi pastaj duhet të kërkojë nga nxënësit, në grupet e tyre, të studiojnë një ligj apo një fushë të ligjeve nga vendi i tyre (siç janë ligjet mbi alkoolin). Ky material duhet të sigurohet në materialet e nxënësve. Nëse ka më shumë kohë në dispozicion, nxënësit mund të marrin materiale të tjera për të cilat ata janë të interesuar, për shembull, të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve dhe adoleshentëve. Çdo grupi i jepen markera (shënues) dhe një fletë e madhe e letrës dhe nga ta kërkohet që të përgatisin një prezentim për klasën, nëse ata mendojnë se ligji(et) të cilët ata i kanë zgjedhur janë ligje të mira apo jo – duke i shfrytëzuar parimet që më parë i kanë identifikuar dhe të cilat janë ekspozuar në murin e klasës.

Grupet ua paraqesin prezentimet e tyre klasës.

Si një ushtrim i fundit apo si detyrë shtëpie, nga nxënësit mund të kërkoni të propozojnë një ligj të ri apo një rregull të re shkollore për një temë sipas zgjedhjes së tyre, siç është mjedisi, dhe të përgatisin argumente për prezentimin e saj, përkitazi me parimet kyçe që ata i kanë identifikuar.

**Mësimi 2****Në cilën moshë?****Si duhet të zbatohet ligji ndaj të miturve?**

<b>Objektivi i mësimnxënies</b>	Të shqyrtojnë si duhet të zbatohet ligji ndaj të miturve.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Të zgjidhin çështjen e moshës ligjore kur të miturit fitojnë të drejtën të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të të rriturve. Të shqyrtojnë sa është adekuat ligji aktual për të miturit.
<b>Burimet</b>	Tri fletë të mëdha të letrës të shënuara me “A”, “B” dhe “C” të vendosura në tri muret e ndryshme të klasës. Kopje të prospekteve për nxënës 8.1 – një për çdo të dytin nxënës. Markera (shënues) dhe një fletë e madhe e letrës për çdo grup me nga 4-6 nxënës.
<b>Metoda</b>	Punë në çifte dhe në grupe të vogla dhe diskutim me tërë klasën.

**Kuti informacioni**

Ky mësim përfshin shumë aktivitete fizike. Nëse mendoni se kjo nuk është e duhur për nxënësit tuaj, ushtrimi kryesor mund të përshtatet, ashtu që nxënësit të qëndrojnë të ulur në bankat e tyre – për shembull, duke votuar me ngritje të dorës, ose me ngritje të skedave “A”, “B” ose “C”, në vend se të lëvizin nëpër pjesë të ndryshme të klasës.

## Mësimi

Mësimdhënësi e fillon mësimin duke e pyetur klasën nëse ata mendojnë se është e drejtë të kemi ligj, me të cilin të miturit i detyrojmë të shkojnë në shkollë, kur një ligj i tillë nuk ekziston për të rriturit:

- A mendoni se është e drejtë të kemi ligj me të cilin të miturit detyrohen të shkojnë në shkollë? Pse po ose pse jo?

Pastaj mësimdhënësi i ndan nxënësit në çifte dhe atyre u jep një pyetësor (prospektet për nxënës 8.1) për ta plotësuar. Pyetësi ka të bëjë me moshën ligjore kur të miturit fitojnë të drejtën që të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të të rriturve në vendin e tyre.

Mësimdhënësi kërkon që disa çifte të paraqiten vullnetarë për të lexuar njërin prej përgjigjeve. Pas çdo përgjigjeje, mësimdhënësi bën një pauzë dhe, nëse është e nevojshme, e korrigjon përgjigjen e nxënësit. Në vazhdim nxënësit e shkruajnë përgjigjen e saktë në pyetësorët e tyre.

Për çdo përgjigje, mësimdhënësi duhet të pyes çiftet:

- Çka mendoni ju? A është kjo moshë:
  - a) shumë e vogël?
  - b) shumë e madhe?
  - c) pothuajse tamam?

Mësimdhënësi u jep çifteve një minutë kohë që të mendojnë dhe të vendosin, dhe kërkon që ata të zhvendosen në një pjesë tjetër të klasës, varësisht nga përgjigjja e tyre. (Mësimdhënësi tanimë ka ngjitur shenjat e mëdha të shënuara “A”, “B” dhe “C” për t’u treguar nxënësve ku të qëndrojnë.)

Mësimdhënësi pastaj kërkon nga çiftet e zgjedhura kuturu t’i shpjegojnë klasës mendimin dhe të arsyetojnë opinionin e tyre. Mësimdhënësi gjithashtu u jep mundësi edhe nxënësve të tjerë që çifteve t’u shtrojnë pyetje për vendimin e marrë.

Për ta përmbyllur këtë pjesë të mësimin, mësimdhënësi pyet:

- A mendoni se është e drejtë që ligji i trajton të miturit ndryshe nga të rriturit? Pse po ose pse jo?

Në vijim mësimdhënësi e ndan klasën në grupe me nga 4-6 nxënës, dhe çdo grupi i jep marker (shënues) dhe një fletë të madhe të letrës. Mësimdhënësi kërkon nga grupet që të mendojnë për ndonjë ndryshim të ligjit në vendin e tyre nga i cili do të përfitonin të miturit. Ata mund të propozojnë një ligj tërësisht të ri – për shembull, që çdo shkollë të ketë parlament të nxënësve apo të sigurohet një pagë minimale për të miturit që janë duke punuar, ose ata mund të propozojnë ndryshim në ligjin ekzistues – për shembull, në ligjin mbi moshën për votim ose moshën për marrjen e patentë shoferit. Çdo grup duhet të përgatisë prezentim për klasën mbi temën e tyre të zgjedhur, duke paraqitur argumentet e tyre dhe duke treguar saktësisht si mendojnë ata se nga ligji i ri do të përfitojnë të miturit. Pas prezenteve, klasa mund të votojë se sugjerimi i kujt grupi ishte më i miri.

Si ushtrim i fundit ose për detyrë shtëpie, nxënësit duhet të marrin parasysh hapat të cilët ata, si të mitur, ose si grup shkollor, mund t’i ndër marrin për të bindur qeverinë që të pranojë ndryshimin(et) në ligj, të cilat ata i propozojnë.



**Mësimi 3****Ju e hartoni ligjin****Si i trajtoni kundërvajtësit e mitur?**

<b>Objektivi i mësimnxënies</b>	Të shqyrtohet çështja nëse të miturit të cilët e kanë shkelur ligjin duhet të dënohen apo jo, dhe nëse po, si.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Të shqyrtohen parimet e ndryshme – ndëshkimi, zhbindja, rehabilitimi – të cilat merren parasysh kur vendoset se çka është dënim i drejtë për një krim që është kryer nga një i mitur.
<b>Burimet</b>	Një kopje e tregimit dhe informacione shtesë për mësimdhënësin.
<b>Metoda</b>	Punë në grupe të vogla dhe diskutim me tërë klasën.

## Të mësuarit konceptual: tri parime themelore për qëllimin e dënimit

Derisa mësimi 2 u përqendrua në të drejtën civile, në këtë mësim do të trajtojmë të drejtën penale, duke u përqendruar në çështjen nëse duhet dënuar kundërvajtësit e mitur apo jo, dhe nëse po, si t'i dënojmë ata. Pyetja kryesore në teorinë e dënimit është “pse duhet dënuar”? Në këtë pyetje janë dhënë përgjigje në mënyra të ndryshme gjatë historisë dhe ka ndryshime në të menduarit shkencor dhe filozofik. Janë shfaqur tri parime lidhur me qëllimin e dënimit.

- 1 **Ndëshkimi.** Dënimi është i lidhur me fajin dhe përgjegjësinë. Krimineli meriton të dënohet, dhe shoqëria e shpreh kundërshtimin për krimin. Ky koncept gjithashtu siguron standardin e proporcionit, duke e mbrojtur në këtë mënyrë kriminelin nga dënimi tepër i ashpër. Qëllimi është që të kthehet drejtësia.
- 2 **Zhbindja.** Dënimi u dërgon një porosi kriminelëve të mundshëm në shoqëri, duke i shkurajuar ata që t'i kthehen krimin, meqë “dhimbja” e dënimit peshon më shumë se përfitimit. Qëllimi është të parandalohet krimi nga të tjerët.
- 3 **Rehabilitimi.** Krimi perceptohet si thirrje për ndihmë. Krimineli ka nevojë për trajtim dhe jo për dënim, dhe qëllimi është që atij t'i ndihmojmë të mos kryej krime të tjera në të ardhmen duke e integruar atë në shoqëri.

Sistemet penale në mbarë botën ndryshojnë shumë në mënyrën se si i balancojnë këto tri parime, edhe për kundërvajtësit e rritur edhe për të miturit. Në përgjithësi, shumë shtete i kanë dhënë prioritet rehabilitimit mbi parimet e ndëshkimit dhe të zhbindjes. Por jo të gjitha shtetet shkojnë në këtë drejtim. Me çështjen e rehabilitimit është e lidhur ngushtë edhe çështja se ku duhet vënë kufirin në mes të keqbërësve të mitur dhe të rritur. Këshilli i Evropës ka kërkuar që kufiri i moshës të jetë 18 vjeç, dhe i është referuar Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989 për ta arsyetuar këtë (shih materialet e prapaskenës vetëm për mësimdhënës).

Ky mësim paraqet tri konceptet kyçe të dënimit të theksuara më lart. Të potencojmë edhe njëherë se këtu zbatohet qasja induktive. Nxënësit merren me studimin e një rasti për një keqbërës të mitur dhe i nxjerrin parimet e ndryshme të dënimit, implikimet e tyre dhe nevojën për balancim. Mësimdhënësi mund të përvijojë konceptet në një ligjëratë të shkurtër gjatë apo pas diskutimit në klasë.

Ky mësim mund t'ia hap derën një projekti pasues për të cilin do të nevojiteshin përafërsisht edhe dy mësimet e tjera. Nxënësit mund të përdorin konceptet që i kanë mësuar në këtë mësim për të përshkruar balancimin që është bërë me legjislacionin penal për keqbërësit e mitur në vendin e tyre.

## Mësimi

Mësimdhënësi e fillon mësimin duke i ndarë nxënësit në grupe me nga 4-6 nxënës. Mësimdhënësi u shpjegon se sundimi i së drejtës përfshin parimin që, gjyqtarët t'i përmbahen ligjit kur kriminelit apo keqbërësit i shqiptojnë dënimin. Në këtë mësim, nxënësit do të shohin mënyrën se si duhet të hartohen ligjet e tilla kur kemi të bëjmë me keqbërësit e mitur. Ata do të dëgjojnë një tregim për një krim dhe çdo grup duhet të supozojë se janë deputet të parlamentit, të cilët duhet të miratojnë ligjin i cili parasheh dënimin që duhet t'i shqiptohet kriminelit.

Mësimdhënësi u parqet nxënësve tregimin themelor dhe u jep mundësinë që ata si grup të vendosin çka mendojnë se do të ishte dënim i drejtë për Tomin. Grupet i paraqesin mendimet e tyre para klasës si tërësi.

Pastaj mësimdhënësi grupeve u jep edhe disa informacione shtesë. Pas çdo informacioni të ri, grupeve u jepet mundësia të ndryshojnë mendimin e tyre për dënimin të cilin fillimisht e kishin planifikuar.

Në fund të këtij aktiviteti, mësimdhënësi kërkon që çdo grup ta paraqet mendimin e tyre para klasës:

- Cilin dënim mendoni se duhet shqiptuar Y-it? Pse?
- A ju bëri ndonjëri nga informacionet shtesë që ta ndryshoni vendimin fillestar? Nëse po, si?

Pastaj mësimdhënësi i afron të gjithë nxënësit së bashku në një sesion plenar dhe i pyet:

- Çfarë faktorësh duhet të merr parasysh ligji kur vendoset mbi dënimin që duhet shqiptuar personit që është dënuar për shkelje?
- A mendoni se ligji duhet t'i trajtojë të miturit ndryshe nga të rriturit? Pse po ose pse jo?

Si ushtrim i fundit ose detyrë shtëpie, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të mendojnë për një rast për të cilin ata kanë dëgjuar –në TV, në gazeta apo ndonjë rast që ka ndodhur në rajonin e tyre – ku një të mituri, i cili e ka shkelur ligjin, i është shqiptuar dënim të cilin ata mendojnë se është qoftë:

- a) shumë i ashpër ose
- b) shumë i butë.

Nxënësit duhet të shkruajnë një fragment të shkurtër për shembullin e tyre të zgjedhur dhe këtë t'ua paraqesin shokëve në mësimin pasues, duke theksuar faktorët në rastin përkatës që shpien në mendimin e tyre për atë. Një shembull do të ishte një rast ku do të përfshihej një person i cili ka pasur aksident automobilistik nën ndikimin e alkoolit.

## Ju e hartoni ligjin

*“Leonardi dhe Tomi që të dy ishin 15 vjeç dhe vijonin mësimin në shkollën e njëjtë. Ata e kishin njohur njëri tjetrin për shumë vite, por ata, në të vërtetë, asnjëherë nuk ishin shoqëruar.*

*Një ditë, telefoni celular i Tomit u raportua i humbur dhe ai e fajësoi Leonardin për vjedhjen e tij. Leonardit tha se nuk e kishte vjedhur atë, por tha se Tomi e xhelozonte pse ai kishte shumë shokë kurse Tomi nuk kishte asnjë.*

*Pas shkollës atë ditë, pati një zënkë. Tomi nxori një thikë edhe pse Leonardit ishte i paarmatosur. Gjatë zënkës, Tomi ia preu faqen Leonardit aq keq, sa që atë e la me vragë në faqe për tërë jetën.”*

## Detyra

Çka mendoni se do të ishte dënim i drejtë për Tomin? Diskutoni këtë pyetje në grupin tuaj dhe pastaj shkruani se çfarë dënimi duhet të parasheh ligji për këtë lloj të shkeljes.

## Informacione shtesë

1. Tomi ishte rritur në mënyrë shumë të rreptë, dhe vazhdimisht ishte rrahur nga babai i tij.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

2. Tomi ishte i izoluar në klasën e tij dhe nuk kishte askënd që atij do t'ia dëgjonte problemet.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

3. Leonard i vërtetë e kishte vjedhur telefonin celular të Tomit dhe ai e kishte filluar zënkën, sepse Tomi kishte raportuar vjedhjen e telefonit celular në polici.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

4. Leonard i ishte udhëheqës i një bande që i kishte rënë në qafë Tomit me muaj të tërë. Banda e kishte rrahur Tomin më shumë se një herë, duke e goditur atë me shkopinj, me zinxhir dhe me shufër të metalit. Kjo i shkaktoi Tomit ankthe dhe ai madje frikohej të shkonte në shkollë.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

5. Babai i Tomit e kishte torturuar Tomin duke i thënë vazhdimisht se ai ishte shumë i butë dhe se duhej të ngrihej kundër ngacmuesve sikurse Leonard.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

6. Tomi e nxori thikën vetëm për t'i frikuar ngacmuesit. Ai asnjëherë nuk kishte menduar se do ta përdorte atë. Në atë kohë, rreth njëzet të rinj po qëndronin përreth, të gjithë duke i inkurajuar djemtë që të përleshin.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

7. Një mësimitdhënës e kishte parë Tomin të sjellë thikën në shkollë dy ditë para zënkës, por ai nuk e kishte pyetur Tomin për të.

A ndikon kjo në mendimin tuaj për dënimin e Tomit? Nëse po, si? Ndryshoni draftligjin tuaj po të jetë e nevojshme.

Nxënësit caktojnë përfaqësues për grupet e tyre, të cilët në vazhdim i paraqesin draftligjet e tyre para klasës. Mund të pritet që të gjithë të jenë të vetëdijshëm për dilemat që përfshijnë qëllimet dhe parimet e drejtësisë që janë në konflikt siç janë të mëposhtmet.

- Si e dëshmojmë se shoqëria e kundërshton sjelljen e tillë?
- Si mund të sigurojmë se shkolla është vend ku është e ndaluar dhuna?
- Sa ashpër duhet dënuar dikë siç është Tomi, për të dekurajuar të tjerët që të mos përdorin thika, siç është banda e Leonardit?
- Sjellja e Tomit është thirrje për ndihmë dhe ai nuk mund ta zgjidhte familjen në të cilën u rrit. Si mund ta ndihmojmë Tomin ashtu që ai të ndihet më i lumtur dhe të mos ketë nevojë të luftojë me thika në të ardhmen?

Mësimitdhënësi mund ta përmbledhë diskutimin duke i lidhur këto tri pyetje me tri parimet – atë të ndëshkimit, zbindjes dhe rehabilitimit. Duke iu referuar Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, mësimitdhënësi mund të propozojë që prioritet t'i jepet rehabilitimit.

Nëse premtan koha dhe nxënësit janë të interesuar, kjo çështje mund të elaborohet më tutje. Nëse ata nuk pajtohen për çështjen se si të balancojnë parimet e ndryshme të dënimit, ky debat duhet të vazhdojë. Nëse ata pajtohen për parimin e rehabilitimit, ata mund të mësojnë se si ligji në vendin e tyre merr parasysh tri parimet – atë të ndëshkimit, zbindjes dhe rehabilitimit.

**Mësimi 4****Rregullat e dëshmisë****Cilat dëshmi duhet të merren parasysh në gjykatë?**

<b>Objektivi i mësimnxënies</b>	Të kuptohen rregullat e dëshmisë në gjykatë.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Të shqyrtojnë llojin e dëshmimeve të cilat duhet të merren parasysh në gjykatë dhe lloji i dëshmimeve të cilat do të ishte gabim të shfrytëzohen.
<b>Burimet</b>	Skeda për diskutim (prospektet e nxënësve 8.2) për çdo grup me nga 4-6 nxënës.
<b>Metoda</b>	Punë në grupe të vogla dhe diskutim në klasë.

**Kuti informacioni**

Njëri prej elementeve kyçe në çdo sistem të drejtësisë penale është një grup i rregullave, të cilat përcaktojnë se cilat lloje të dëshmisë duhet dhe cilat nuk duhet të shfrytëzohen në gjykatë, në mënyrë që gjykimi të jetë i drejtë. Për shembull, është e drejtë që të përdoret dëshmia “dëgjo dhe thuaj” (d.m.th., dëshmi që nuk është përjetuar drejtpërdrejt nga dëshmitari, por që atyre u raportohet nga dikush tjetër), dëshmi e marrë si rezultat i torturës ose kërcënimit me dhunë, ose dëshmi e marrë përmes “pyetjeve sugjestive/tendencioze”, që do të thotë., pyetje që u ngjisin fjalë dëshmitarëve?

## Mësimi

Mësimdhënësi e fillon mësimin duke i paraqitur dispozitat vijuese nga KEDNJ (1950), edhe gojarisht edhe në formë të shkruar në dërrasën e zezë apo në tabelën shfletuese (flip chart):

“Çdokush i akuzuar për vepër penale prezumohet (konsiderohet) i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij sipas ligjit.”

*Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (1950), neni 6, nr. 2*

Mësimdhënësi fton nxënësit që ta shpjegojnë këtë dispozitë. Mësimdhënësi mund të shtojë kategorinë e prezumimit (konsiderimit) fillestar të pafajësisë. Nxënësit duhet ta kuptojnë rëndësinë e këtij parimi për një gjykim të drejtë, dhe duhet të mësojnë se personi i akuzuar mund të dënohet vetëm nëse sigurohen dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e tij. Në këtë mësim, nxënësit do të shikojnë rregullat e dëshmisë në gjykatë.

Nxënësit duhet të formojnë grupe me nga 4-6 vetë.

Në vijim mësimdhënësi u tregon grupeve për një proces gjyqësor, i cili është duke u zhvilluar. Ka të bëjë me një të ri të quajtur Manuel, i cili akuzohet për vjedhjen e një veture që i përket z. Kay. Vetura u zhdruk jashtë shtëpisë së z. Kay vonë një mbrëmje, dhe u gjet e lënë jashtë fshatit të nesërmen në mëngjes. Ishte lagur me benzinë dhe ia kishin vënë zjarrin. Manuel ishte arrestuar nga policia kah fundi i javës, dhe akuzohej për vjedhje dhe dëm penal.

Në vazhdim mësimdhënësi secilit grupi i jep një seri skedash për diskutim. Çdo skedë përfshin një dëshmi që prokuroria e përdor në gjykatë për t’u përpjekur të vërtetojë se Manuel është fajtor.

Mësimdhënësi nga grupet kërkon që të:

- rendisin pjesët e dëshmisë – nga ato më bindëse tek ato të rrëzueshme;
- vendosin nëse pjesë të dëshmive duhet të përjashtohen në tërësi sepse ato janë qoftë irelevante apo të padrejta.

Mendimet e tyre grupet ia paraqesin pjesës tjetër të klasës dhe përpiqen të arrijnë marrëveshje për ato pjesë të dëshmive të cilat duhet të pranohen dhe ato të cilat duhet të përjashtohen në tërësi.

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të kthehen në grupet e tyre dhe të mendojnë:

- Cilat pyetje do të dëshironit ju që gjykata t’ua parashtrojë këtyre dëshmitarëve apo Manuelit tani? Pse?
- A ka ndonjë lloj të pyetjeve që do të ishte e padrejtë gjykata t’ua parashtrojë atyre? Nëse po, cilat janë ato dhe pse?

Grupet paraqesin mendimet e tyre dhe klasa, duke punuar bashkërisht, përpiqet të përpilojë lista me llojet e dëshmive dhe llojet e pyetjeve, të cilat ata mendojnë se do të ishte gabim të përdoren në gjykatë.

Nëse premton koha, ky mësim mund të shpie në një detyrë kërkimore. Për detyrë shtëpie, nga nxënësit kërkohet që ata të studiojnë rregullat e dëshmisë të cilat zbatohen në proceset gjyqësore penale në vendin e tyre, dhe konstatimet e tyre t’ua paraqesin klasës në mësimin pasues.

## Prospektet për nxënës 8.1

### Një pyetësor: në cilën moshë?

Në cilën moshë ligji në vendin tuaj lejon të rinjtë të:

- 1 Kenë patentë shoferi?
- 2 Martohen?
- 3 Votojnë në zgjedhje?
- 4 Shkojnë në ushtri?
- 5 Paguajnë taksa?
- 6 Mbajnë post politik?
- 7 Burgosen?
- 8 Lënë shkollën?
- 9 Adoptojnë një fëmijë?

## Prospektet për nxënës 8.2

### Skedat për diskutim

<p>Një polic i tregon gjykatës se Manuel kishte pranuar se e ka vjedhur veturën kur ishte marrë në pyetje në stacionin e policisë.</p>	<p>Një i ri i tregon gjykatës se Manuel gjithmonë mburret për vjedhjen e veturave.</p>
<p>Një vajzë e re i tregon gjykatës se ajo ka dëgjuar padashur një shok të saj duke biseduar me Manuel në telefonin e tij celular. Shoku i saj bisedonte me Manuelin për t'ia vjedhur z. Kay veturën.</p>	<p>Z. Kay i tregon gjykatës se ai mendon që Manuel duhet të jetë i dyshuari kryesor, sepse atij i kishte lindur një mëri kundër familjes Kay që kur z. Kay e ndaloi Stefanin që të takohet me vajzën e tij</p>
<p>Njëri prej mësimdhënësve të Manuelit i tregon gjykatës se si e ka zënë Stefanin duke vjedhur nga shkolla disa herë në kohën kur ka qenë në shkollë.</p>	<p>Manueli nuk e ka askënd për të mbështetur alibinë e tij se ai ishte në shtëpi në mbrëmjen kur u vjedh vetura.</p>
<p>Kur është pyetur nga prokurori, a e ka parë një të ri si Manuel duke vozitur veturën atë mbrëmje?”, një fqinj i Kay i tha gjykatës, “Po, e kam parë”</p>	



## 8.1 Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

### Integrimi, jo kriminalizimi

*Thomas Hammarberg, Komisioner për të drejtat e njeriut, Këshilli i Evropës*

Në shumicën e shteteve evropiane, adoleshentët nuk dominojnë në statistikat e përgjithshme të krimit. Gjithashtu, shkalla e krimeve të kryera nga të miturit qëndron pak a shumë stabile nga viti në vit në mbarë kontinentin tonë.

Kjo nuk do të thotë se problemi është i parëndësishëm. Një tendencë brengosëse që është raportuar nga disa shtete është se disa krime të kryera nga kundërvajtësit e mitur janë bërë më të dhunshme ose përndryshe më të rënda. Ky vetvetiu është një sinjal alarmues. (...).

Aktualisht, në Evropë janë dy tendenca të ndryshme. Njëra është të zvogëlohet moshja e përgjegjësive penale dhe të burgosen më shumë fëmijë në moshat e reja. Tendenca tjetër është – në frymën e Konventës së KB-së mbi të Drejtat e Fëmijës – t'i shmangemi kriminalizimit, dhe në vend të burgimit të kërkojmë alternativa të bazuara në familje apo alternativa të tjera shoqërore.

Unë do të argumentoj qasjen e dytë. Për këtë kam mbështetje jo vetëm në Konventën e KB-së por edhe në Rrjetin Evropian të Ombduspersonave të Fëmijëve. Në një deklaratë të vitit 2003, jo më pak se 21 ombudspersona kombëtarë theksuan se fëmijët në konflikt me ligjin janë, para së gjithash, fëmijë të cilët akoma gëzojnë të drejtat e njeriut.

Ata propozuan që moshja e përgjegjësive penale të mos ulet por të rritet – me qëllim që gradualisht të arrihet moshja 18 vjeçare – dhe të provohen metodat inovative për t'ju përgjigjur keqbërësve të mitur nën këtë moshë, me një përqendrim të vërtetë në edukimin e tyre, riintegrimin dhe rehabilitimin.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës – e ratifikuar nga të gjitha shtetet evropiane – kërkon nga qeveritë që të caktojnë moshën minimale, nën të cilën fëmijët do të konsiderohen se nuk e kanë aftësinë që të shkelin ligjin penal. Traktati nuk e cakton saktësisht moshën ku duhet vënë kufirin. Mirëpo, Komiteti i cili monitoron zbatimin e Konventës ka shprehur shqetësimin për moshën ligjore në disa shtete. Në shumicën e shteteve evropiane, fëmijët përgjigjen penalisht në mes të moshës 12 dhe 15 or 16 vjeçare, por ka edhe shembuj të kufizimeve të moshës që shkojnë deri në 7, 8 dhe 10.

Edhe pse porosia e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës është që t'i shmangemi kriminalizimit të fëmijëve, kjo nuk do të thotë se kundërvajtësit e mitur duhet të trajtohen sikur të mos kishin fare përgjegjësi. Përkundrazi, është me rëndësi që kundërvajtësit e mitur të përgjigjen për veprimet e tyre dhe, për shembull, të marrin pjesë në riparimin e dëmit që e kanë shkaktuar.

Shtrohet pyetja se çfarë mekanizmi duhet të zëvendësojë sistemin e zakonshëm të drejtësisë penale në rastet e tilla. Procedura duhet të pranojë dëmin që i është shkaktuar viktimës dhe duhet ta bëjë kundërvajtësin e mitur të kuptojë se vepra ishte e papranueshme. Një mekanizëm i tillë i veçantë për të mitur duhet të synojë që i mituri të pranojë fajin, dhe të shqiptohen sanksione të cilat kanë karakter rehabilitues.

Ndryshimi nga procedura e zakonshme penale është në procesin e sanksionimit. Në drejtësinë për të mitur nuk duhet të ketë ndëshkim. Qëllimi është që të vendoset përgjegjësia dhe, në të njëjtën kohë, të përkraket riintegrimi. Kundërvajtësi i mitur duhet të mësojë nga ky mësim/përvojë dhe asnjëherë të mos e përsërisë keqbërjen.

Kjo në realitet nuk është e lehtë për t'u arritur. Për këtë nevojiten sanksione me punë në dobi të komunitetit, të cilat janë risi dhe efektive. Në parim, duhet të përfshihen prindërit e keqbërësit apo kujdestari tjetër ligjor, përveç nëse kjo konsiderohet kontraproduktive për rehabilitimin e fëmijës. Cilido proces qoftë, fëmija duhet të ketë mundësi që të kundërshtojë akuzat, madje edhe të paraqesë ankesë.

Në Slloveni është prezentuar një procedurë interesante për arritjen e “marrëveshjeve”. Atje, rasti i një të mituri të akuzuar mund t’i referohet ndërmjetësit nëse pajtohet prokurori, viktima dhe i akuzuari. Pastaj ndërmjetësi përpiqet të arrijë marrëveshje e cila do të ishte e pranueshme për viktimën dhe për të akuzuarin, dhe kështu mund t’i shmangemi procesit gjyqësor.

Duhet potencuar edhe një aspekt tjetër: rëndësinë për t’ju përgjigjur menjëherë keqbërësit. Procedurat e vonuara – të cilat sot janë problem në disa shtete evropiane – janë veçanërisht të pasuksesshme kur kemi të bëjmë me keqbërësit e mitur, veprimet e këqija të të cilëve duhet parë si thirrje për ndihmë të menjëhershme. (...)

*Thomas Hammarberg, Komisioner për të drejtat e njeriut, Këshilli i Evropës, fragment nga “The human rights dimension of juvenile justice”, prezentim i paraqitur në Konferencën e prokurorëve të përgjithshëm të Evropës, Moskë, 5-6 korrik 2006. Burimi: <http://www.coe.int/t/commissioner/>*

## 8.2 Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

### Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

Miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve të Bashkuara, me 20 nëntor 1989

#### “Neni 37

Shtetet që janë palë e Konventës do të sigurojnë që:

- (a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës apo trajtimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor apo degradues. Pa mundësi të lirimit, as dënimi me vdekje as burgimi i përjetshëm nuk shqiptohen për vepra penale të kryera nga persona nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare;
- (b) Asnjë fëmijë të mos privohet nga liria e tij në mënyrë të paligjshme apo arbitrare. Arrestimi, ndalimi apo burgimi i fëmijës do të jetë në pajtim me ligjin dhe do të përdoret vetëm si mjet i fundit, dhe për një periudhë kohore sa më të shkurtër të mundshme;
- (c) Çdo fëmijë i privuar lirie trajtohet me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e qenësishëm të personit, dhe në mënyrën e cila merr parasysh nevojat e personit të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar lirie veçohet nga të rriturit, përveç nëse kjo konsiderohet se është në interesin më të mirë të fëmijës që të mos veçohet, dhe ai do të ketë të drejtë të mbajë kontakte me familjen e tij përmes korrespondencave apo vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme;
- (d) Çdo fëmijë i privuar lirie ka të drejtë në qasje të menjëhershme në ndihmë juridike dhe në ndihma të tjera të duhura, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë për privimin e tij nga liria pranë një gjykate apo autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm, dhe të drejtën për vendim të menjëhershëm për cilindo nga veprimet e tilla.”

#### “Neni 40

- (...) 3. Shtetet që janë palë të Konventës përpiqen të përkrahin hartimin e ligjeve, vendosjen e procedurave, të autoriteteve dhe të institucioneve, të cilët do të zbatohen veçanërisht për fëmijët për të cilët pohohet se kanë bërë shkelje, akuzohen për shkelje ose njihen si të mitur të cilët e kanë shkelur ligjin penal, dhe në veçanti:
  - (a) Caktimi i moshës minimale nën të cilën fëmijët do të konsiderohen se nuk kanë zotësinë të shkelin ligjin penal;
  - (b) Çdoherë kur është e duhur dhe e dëshirueshme, caktimi i masave për trajtimin e fëmijëve të tillë, pa përdorimin e procedurave gjyqësore, me kusht që të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e tyre të respektohet plotësisht.
4. Në dispozicion do të jenë një sërë rregullimesh, siç janë kujdesi, urdhrat për shoqërim dhe mbikëqyrje; këshillimi; lirimi me kusht; kujdesi për ushqimin; edukimi dhe programet e aftësimi profesional si dhe alternativa të tjera të kujdesit institucional, për të siguruar që fëmijët të trajtohen në mënyrën e cila është adekuate për mirëqenien e tyre dhe është proporcionale me rrethanat e tyre dhe me veprën penale.”

Burimi: Rolf Gollob/Peter Krapf: Exploring children’s rights. Seri e mësimëve për shkolla fillore. EDC/HRE, Vol. V, Strasbourg 2007, pp. 77ff.

Për lexim të mëtejshëm: Cyndi Banks, Criminal justice ethics, Thousand Oaks, 2004. A PDF version i Kapitullit 5, The Purpose of Criminal Punishment, gjendet në <http://www.sagepub.com>.